

AKT THEMELIMI

DHE

STATUT

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“PEÇI & PAPAGJONI” SH.P.K

**AKT THEMELIMI & STATUT
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“PEÇI & PAPAGJONI” SH.P.K**

Sot më 20.03.2024 (dymijë e njëzetë e katër), personat si më poshtë:

1. **Spiro Peçi**, i biri i Kostandin dhe i Elefteria, lindur më 17.02.1947, në Kakodhiq, Sarandë, banues në Rr. “Thoma Kacorri”, Tiranë, Shqipëri, shtetas shqiptar, mbajtës i Letër Njoftimit Nr. 035594018, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;
2. **Idlir Peçi**, i biri i Spiro dhe i Jenovefa, lindur më 28.08.1975, në Sarandë, banues në Rr. “Emin Duraku”, Tiranë, Shqipëri, shtetas shqiptar, mbajtës i Letër Njoftimit Nr. 038398504, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, dhe
3. **Erilda Papagjoni**, e bija e Mitro dhe Liljana, lindur më 28.08.1984, në Sarandë, banuese në Rr. “Artan Lenja”, Tiranë, Shqipëri, shtetase shqiptare, mbajtëse e Letër Njoftimit Nr. 033813223, madhere, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar,

në mbështetje të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, i ndryshuar, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë kanë rënë dakort dhe vendosin të themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe të hartojnë këtë Statut, mbështetur në parimet dhe kushtet e më poshtme:

**KREU I
EMRI, FORMA JURIDIKE, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI**

Neni 1

Emri

1.1 Shoqëria tregtare ka emërtimin **“PEÇI & PAPAGJONI” sh.p.k.**

**Neni 2
Forma Juridike**

3.1 Shoqëria ka statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe ortakët do të përballojnë humbjet deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të tyre të nëshkruara për kapitalin.



The image shows three handwritten signatures in blue ink. From left to right: 1) A signature that appears to be "spc", followed by the number "[1]". 2) A signature that appears to be "Idlir", followed by a small dot. 3) A signature that appears to be "Erilda", enclosed in a circle.

Neni 3
Selia

- 3.1 Shoqëria e ka selinë e saj në adresën: Rr. "Nikolla Jorga", Nd. 3, H. 2, Ap. 2, Njësia Administrative Nr. 7, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.
- 3.2 Me miratim të organeve të saj kompetente shoqëria mund të ndryshojë selinë. Ajo mund të hapë degë, zyra përfaqësimi dhe vende të tjera të ushtrmit të veprimtarisë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj.

Neni 4
Kohëzgjatja

- 4.1 Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.

Neni 5
Objekti

- 5.1 Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë ofrimin e shërbimeve të konsulencës në fusha të tillë si, por pa u kufizuar: konsulencë ligjore, fiskale-tatimore, energji, mjedis, kujdesit shëndetësor & farmaceutikës, përputhshmërisë, përafrimit të legjislacionit vendas me legjislacionin e BE, sigurisë në aviacionin civil, konsulencë në fushën civile, tregtare, administrative, penale dhe të drejtat e njeriut, përfaqësim administrativ, gjyqësor, jashtëgjyqësor dhe arbitrazh, zgjidhje alternative të konflikteve dhe ndërmjetësim, etj., si dhe të kryejë çdo aktivitet ndihmës në shërbim të objektit të saj dhe veprimtarive të mësipërme.
- 5.2 Shoqëria mund të zgjerojë dhe/ose të pakësojë rast pas rasti objektin e veprimtarisë së vet me vendim të organeve të saj kompetente.

KREU II
KAPITALI

Neni 6
Kapitali

- 6.1 Kapitali themeltar total i nënshkruar i shoqërisë është 100 (njëqind) lekë dhe ndahet në 3 kuota, me vlerë nominale sipas kontributit të secilit ortak në shoqëri të treguar në nenin 6.2, që jep të drejta vote proporcionale.
- 6.2 Kapitali është tërësisht në para dhe është nënshkruar dhe shlyer nga ortakët si më poshtë:

[2]



The image shows three handwritten signatures in blue ink. From left to right: 1) A signature that appears to be 'J. Jorga'. 2) A signature that appears to be 'K. Kremshi'. 3) A signature that appears to be 'B. Boçka'.

Emri	Kuotat (Pjesë)	Vlera Nominale e Kuotës (Lekë)	Shuma e Kontributit (Lekë)	Përqindja e Kapitalit & Të Drejtat e Votave (%)
Spiro Peçi	1	10.00	10.00	10
Idlir Peçi	1	60.00	60.00	60
Erilda Papagjoni	1	30.00	30.00	30
TOTAL	3	100.00	100.00	100

- 6.3 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve, por asnjëherë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin ligjor.

Neni 7 Kuotat

- 7.1 Kuota e kapitalit të shoqërisë mund të zotërohet nga një ose më shumë persona.
- 7.2 Në rastin kur një kuotë e kapitalit të shoqërisë zotërohet nga më shumë se një person, në marrëdhënie me shoqërinë, këta persona trajtohen si një ortak dhe të drejtat e tyre ushtrohen, nëpërmjet një përfaqësuesi të përbashkët. Këta persona përgjigjen personalisht dhe në mënyrë solidare për detyrimet që lindin nga zotërimi i kuotës.
- 7.3 Veprimet e shoqërisë ndaj kuotës së zotëruar nga më shumë se një person krijojnë pasoja ndaj të gjithë zotëruesve të saj edhe nëse veprimi i shoqërisë i drejtohet vetëm njërit prej zotëruesve.
- 7.4 Shoqëria mund të lëshojë një çertifikatë për të vërtetuar zotërimin e kuotës së kapitalit. Kjo certifikatë lëshohet në emër të personit apo të personave, që zotërojnë kuotën dhe nuk përbën letër me vlerë.

Neni 8 Mënyrat e Fitimit dhe Kalimit të Kuotave

- 8.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - ç) dhurimit;
 - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

- 8.2 Ortakët mund të transferojnë lirisht kuotat ndërmjet tyre dhe tek të tretë pa nevojën e ndonjë miratimi paraprak.
- 8.3 Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit në QKB.

KREU III ORGANET E SHOQËRISË

Neni 9

- 9.1 Organet drejtuese të shoqërisë janë:
 - (i) Asambleja e Përgjithshme;
 - (ii) Administratori/ët;
- 9.2 Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet si më poshtë.

TITULLI I ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Neni 10 Kompetencat

- 10.1 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të çështjeve të më poshtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorit/ve;
 - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesit/ve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) përcaktimin e shpérblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të këtij neni;
 - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori/ët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë të përgatitura nga administratori;
 - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit/ëve;
 - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë;

[4]



- m) miraton ndarjen e fitimeve dhe dividentëve;
- n) të kryejë detyra të tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 11 **Mbledhja e Asamblesë**

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimor i shoqërisë. Ajo mblidhet sa herë që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë si dhe për të gjitha rastet e parashikuara në nenin 82 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 për "Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare". Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithëshme thirret të paktën një herë në vit.
- 11.2 Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori/ët ose nga ortatakët e shoqërisë.
- 11.3 Mbledhja mbahet në selinë e shoqërisë ose në çdo vend dhe mënyrë tjetër që shihet e përshtatshme nga ortakët.

Neni 12 **Thirrja dhe Pjesëmarrja në Asamble**

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me postë elektronike. Njoftimi duhet të përbajë vendin, mënyrën e mbledhjes kur është e ndryshme nga mbledhja fizike, datën, orën e mbledhjes, rendin e ditës dhe ju dërgohet të gjithë ortakëve jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 12.2 Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
- 12.3 Ortakët mund të marrin pjesë në mbledhje personalisht ose të përfaqësuar sipas parshikimeve ligjore.
- 12.4 Ortakët mund të marrin pjesë në mbledhje fizikisht ose jo fizikisht nëpërmjet mjeteve të ndryshme të komunikimit, përfshirë mjetet elektronike, që mundësojnë identifikimin e tyre, të tilla por pa u kufizuar si:
 - a) transmetimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme në kohë reale, si video koferencë, etj;
 - b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nga një vendndodhje tjetër, si konferencë telefonike, etj;
 - c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së Asamblesë se Përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje, si projekt vendim qarkullues në formë elektronike, postare apo dorazi, ku secili prej ortakëve jep miratimin e tij me shkresë duke nënshkruar vendimin përkatës (vendim qarkullues), etj.
- 12.5 Për efekt të këtij neni, konsiderohen mjete dhe burime të sigurta identifikimi për

të kryer njoftimin për mbedhjen e Asamblesë së Përgjithshme si dhe për të garantuar pjesëmarrjen jo fizike të ortakëve në mbledhje:

- (i) adresat postare, elektronike dhe numrat e telefonit të dorëzuara në formë shkresore (përfshirë e-mail, sms, aplikacione) nga ortakët tek Administratori/ët i shoqërisë, ortakë të tjerë të shoqërisë, ose punonjës të autorizuar të shoqërisë; dhe/ose
- (ii) adresat postare, elektronike dhe numrat e telefonike të përdorura nga ortakët, me të cilat ato kanë mbajtur korrespondencë të vazhdueshme me Administratorin/ët, ortakët e tjerë, apo anëtarë/punonjës të tjerë të shoqërisë dhe që njihen gjerësisht se i përkasin atij; dhe/ose
- (iii) sitemet teknologjike të lidhjes audio dhe vido që disponon shoqëria.

Neni 13 Kuorumi dhe Vendimmarrja

13.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 % të kuotave. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë ose mjete elektronike sipas parashikimeve të këtij Statuti.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur më sipër, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

13.2 Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesmarrës (shumicë e kualifikuar), për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë dhe për raste të tjera që sipas këtij Statuti kërcohët shumicë e cilësuar. Për çështjet e tjera të renditura në nenin 10 të këtij Statuti, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

13.3 Të gjitha vendimet e Asamblesë regjistrohen në procesverbal i cili përban datën, orën e vendin dhe/ose mënyrën e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e Kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit dhe rezultatet e votimit. Prosesverbalit nënshkruhet nga Kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit. Prosesverbalit i bashkangjitet dhe lista e pjesëmarrësve dhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme. Administratori/ët është/janë përgjegjës për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve.

13.4 Mbledhja e Asamblesë kryesohet nga një prej anëtarëve të saj të caktuar rast pas rasti nga Asambleja.

TITULLI II ORGANI ADMINISTRATIV

Neni 14

14.1 Asambleja e Përgjithshme mund të emëroj rast pas rasti një ose më shumë Administrator të shoqërisë.

14.2 Administrator i parë i shoqërisë me mandat 5 vjeçar caktohet:

- 1) **Erilda Papagjoni**, e bija e Mitro dhe Liljana, lindur më 28.08.1984, në Sarandë, banuese në Rr. "Artan Lenja", Tiranë, Shqipëri, shtetase shqiptare, mbajtëse e Letër Notimit Nr. 033813223.

Neni 15 Kompetencat

15.1 Asambleja e Përgjithshme emëron dhe shkarkon Administratorin/ët e shoqërisë, në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj arsy, me shumicë të zakonshme. Administratori/ët mundet gjithashtu të jap dorëheqjen sipas parashikimeve të ligjit.

15.2 Afati i emërimit të Administratorit/ëve është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhje.


15.3 Administratori/ët ka/në këto kompetenca:

- a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) të përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'i paraqesi këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- e) të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) të kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- g) të raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe këtë Statut.

Administratori/ët është kompetent edhe për të:



[7]



- (i) realizuar mbledhjen e asamblesë duke njoftuar ortakët me shkrim jo më vonë se 7 ditë më parë;
- (ii) propozuar strukturen e aparatit te shoqërisë, hapjen, përcaktimin, zhvillimin e deputamenteve të shoqërisë dhe të vendeve të tjera të ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë;
- (iii) marrë dhe shkarkojë nga puna personelin dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me të gjithë punonjësit.
- (iv) propozuar rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve të ndryshme në interes të shoqërisë.

KREU IV PRISHJA E SHOQËRISË

Neni 16

16.1 Shoqëria prishet në rastet e më poshtëme:

- a) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- b) në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunkcionimit të vazduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- c) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga ligj;
- d) në raste të tjera të parashikuara në statut;
- e) në raste të tjera të parashikuara me ligj;
- f) për çdo shkak tjetër të vendosur nga Asambleja e Përgjithshme.

16.2 Me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, prishja e shoqërisë sjell hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese. Gjatë fazës së likuidimit emrit të shoqërisë i shtohet pjesa "Në likudim" që shënohet në të gjitha dokumentet që shoqëria nxjerr gjatë kësaj perjudhe.

16.3 Likujduesi i emëruar nga Asambleja e Përgjitheshme, kërkon çregjistrimin e shoqërisë pranë QKB, pas shpërndarjes së aktiveve të mbeturë të shoqërisë.

KREU V VITI FINANCIAR

Neni 17

17.1 Në përputhje me ligjin shoqëria do të ketë një regjistër në të cilën mbahen bilance vjetore, raporte financiare vjetore dhe çdo kërkesë tjetër ligjore.

[8]

Neni 18

18.1 Viti finanziar i shoqërisë fillon në 1 Janar të çdo viti kalendarik dhe përfundon në 31 Dhjetor të po këtij viti, me përjashtim të vitit të regjistrimit ku viti finanziar fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë dhe përfundon më 31 Dhjetor.

KREU VI DIVIDENTËT

Neni 19

19.1 Pas miratimit të bilancit vjetor dhe shpërndarjes së të ardhurave dhe mbajtjes së rezervës ligjore, Asambleja përcakton shumën që do të ndahet si divident, në përpjestim me kuotën që zotëron çdo ortak.


KREU VII PARASHIKIME PËRFUNDIMTARE

Neni 20


- 20.1 Shoqëria ka vulën e vet në të cilën shkruhet emri i shoqërisë siç e prashikon ligji.
- 20.2 Për ato që nuk janë parashikuar në këtë Statut zbatohen dispozitat e ligjit.
- 20.3 Statuti është hartuar në 3 (tre) kopje origjinale, në gjuhën shqipe, me të njëjtën fuqi ligjore.

Ortakët e shoqërisë, pasi e lexuan këtë Statut, deklarojnë se e kanë kuptuar përbajtjen e saj dhe janë dakort me kushtet e saj, prandaj e nënshkruajnë atë me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë si më poshtë vijon, si shprehje e qëllimit dhe miratimit të tyre.

ORTAKËT THEMELUES

Spiro Peçi 
Spiro Peçi

Idlir Peçi 
Idlir Peçi

Erilda Papagjoni 
Erilda Papagjoni